



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:144225  
Datë: 27.06.2024  
Numri i dokumentit: 05870798

CAP.nr.824/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtaren individuale Nora Bllaca-Dula, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit N.P “T.....” SH.A, me seli në P....., Rr.“.....” nr....., ndaj debitores V.B, me vendbanim në P....., Rr. “.....” C-..... H: ..... H1-Nr....., të cilën në bazë të autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “P.....”, me seli në Prishtinë, për përmbushjen në të holla, duke vendosur në lidhje me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.369/23, i datës 03.10.2023, me datë 27.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e debitores V.B, me vendbanim në P....., Rr. “.....” C-..... H: C.. H1-Nr..., ANULOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.369/23, i datës 03.10.2023 dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në procedim të serishëm.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin PPP.nr.369/23, i datës 03.10.2023, ka vendosur si në vijim: “I. REFUZOHET i pabazuar prapësimi i përfaqësuesit të autorizuar të debitores V.B nga P....., i ushtruar kundër Urdhrit për lejimin e përmbarimit P.nr.208/23 i datës 23.05.2023, të lejuar nga Përmbaruesit Privat A. B në Prishtinë.

II. Në rast se pala debitore parashtron ankesë kundër këtij aktvendimi, OBLIGOHET që në afat prej 7 (shtatë) ditësh ta paguajë garancionin në mjetet buxhetore të gjykatës në shumën prej 550.08 €.

*III. Në rast se pala debitore dështon të paguajë shumën e lartëcekur të garancionit brenda afatit të caktuar, ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi do të konsiderohet se nuk është dorëzuar fare.”.*

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur debitori për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, ta aprovoj ankesën ashtu që aktvendimin e atakuar ta anuloj dhe çështjen ta kthej në rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur kreditori.

Gjyqtarja individuale e Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas shqyrtimit të tyre, konform nenit 3 paragrafi 2 të Ligjit të Procedurës Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194, 208 dhe 209 të LPK-së, gjeti se:

*-Ankesa është e debitorit është e themeltë.*

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori ka paraqitur propozim për përmbartim me datë 23.05.2023 ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm –kartelës nr..... të datës 23.05.2023 në shumën prej 550.08 €, me propozim që të lejohet përmbartimi dhe të obligohet debitori që në afat prej 7 ditësh si dhe shpenzimet e përmbartimit.

Përmbartuesi Privat, me urdhrin P.nr.208/2023, i datës 23.05.2023, ka lejuar përmbartimin. Kundër urdhrin për lejimin e përmbartimit, brenda afatit ligjor, debitori përmes përfaqësuesit të autorizuar ka paraqitur prapësim. Në prapësimin e ushtruar, ndër tjera pretendohet se urdhri përmbartimor është marrë në kundërshtim me nenin 71 par.1 pika 1.4 të LPP-së, për shkak se bazuar në nenin 360 par.1.1 të LMD-së, kemi parashkrim të kërkesave reciproke, përkatësisht të vetë kërkesës, pasi kanë kaluar afatet ligjore për realizim në mënyrë të dhunshme. Tutje pretendohet se propozimit i është bashkangjitur kartela financiare e konsumatorit e lëshuar nga kreditori, duke mos bashkangjitur asnjë faturë, që ka qenë edhe obligim ligjor i palës kreditore në raport me konsumatorët. Mbi bazën e këtyre pretendimeve, ka propozuar që urdhri Përmbartimor të anulohet si i pa bazuar.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim, duke pretenduar se prapësimi i debitorit është bërë vetëm sa për prolongim të procedurës, ndërsa sa i përket faktit se debitori është thirrur në parashkrim të kërkesës, kreditori pretendon se kemi të bëjmë me borxh periodik, ndërsa në rastin konkret kemi ndërprerje të parashkrimit, për faktin se debitori ka bërë disa pagesa në periudha të ndryshme, duke e pranuar në këtë mënyrë borxhin. Mbi bazën e këtyre pretendimeve, ka propozuar që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin, PPP.nr.369/23, i datës 03.10.2023, e ka refuzuar në tërësi prapësimin e debitorit duke e lënë në fuqi urdhrin e përmbartuesit privat, duke vendosur më decidivisht si në dispozitivin e të njëjtit.

Në arsyetim të aktvendimit ka theksuar se pas analizimit të shkresave të lëndës, ka theksuar se në rastin konkret, propozimi për përmbarrim është lejuar në bazë të kartelës së kontabilitetit nën shifrën ID nr.011383, të dt.23.05.2023, e për të cilin dokument gjykata vlerëson se paraqet dokument të besueshëm në kuptim të nenit 29 par.1 pika.1.2 lidhur me par.3 të LPP-së. Gjykata i vlerësoi pretendimet e ngritura nga ana e debitorit lidhur me parashkrimin e kërkesës në kuptim të dispozitës së nenit 341 par.3 të LMD-së dhe lidhur me pretendimet e tilla iu referua dispozitës nga neni 360 par.1 nënpar.1 të LMD, mirëpo në rastin konkret bëhet fjalë për borxhin e akumuluar për periudhën kohore 31.10.2020 deri me dt.30.04.2022. Nga interpretimi i dispozitës së lartëcekur nga neni 360 par.1 nënpar.1 të LMD-së, gjykata fillimisht vlerëson se borxhi i akumuluar për vitin kalendarik 2020, mund të kërkohej më së voni deri me dt.31.12.2020, pasi me kalimin e një periudhe të tillë konsiderohet i parashkruar. Në anën tjetër, nga shkresat e lëndës gjykatës i ka rezultuar se debitori ka bërë pagesë në muajin dhjetor të vitit 2021, duke vazhduar tutje me pagesa tjera në muajt janar 2022, shkurt 2022, mars 2022 dhe prill 2022. Përmes këtyre veprimeve, gjykata vlerëson se ka ardhur në shprehje ndërprerja e parashkrimit, në kuptim të dispozitës nga neni 368 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve Ligji nr. 04/L-077, ku përcaktohet: *“Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin. Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit.”* Si rezultat i një interpretimi të tillë, vlerësimi përfundimtar i gjykatës konsiston në faktin se afati i fundit për kreditorin për të kërkuar përmbushjen e detyrimit në raport me debitorin është data 31.12.2023. Bazuar në faktin se propozimi për përmbarrim është paraqitur me datën 23.05.2023, rrjedh se nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës në këtë çështje përmbarrimore. Në anën tjetër, nga kartela e kontabilitetit, gjykata vërtetoi faktin se pas zbritjes së shumës së borxhit e cila është paguar nga shuma e tërësishme e borxhit brenda periudhës së specifikuar, borxhi i mbetur rezulton të jetë në shumën prej 550.08 €.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit nuk e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë me shkëlqje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.1 lidhur me nenin 27 dhe 38 të LPP-së, nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë gjendja faktike si dhe kemi zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Dispozitivi i aktvendimit është i pakuptueshëm, në kundërshtim me arsyet e aktvendimit e po ashtu arsyet e paraqitura lidhur me faktet vendimtare të çështjes janë të mangëta dhe të paqarta. Gjendja faktike rezulton të mos jetë vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë me çka ka ardhur edhe deri te aplikimi i gabuar i të drejtës materiale.

Fillimisht Gjykata e Apelit, vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vepruar në kundërshtim me nenin 38 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore i cili përcakton se: *“Propozimi për përmbarrim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarrim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarrimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohej përmbarrimi, kërkuesi i përmbarrimit dhe debitori, adresa e vendbanimit –vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohej të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet të cilit duhet kryer përmbarrimi, objekti i përmbarrimit po që se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarrimit”*. Gjykata e shkallës së parë ka vepruar në kundërshtim

edhe me nenin 27 të Ligjit për Procedurën Përmbaremore, i cili në mënyrë të qartë tregon se kur është një dokument përmbaremore i përshtatshëm për përmbaremore, ndër të tjera ky nen përcakton se: *“Dokumenti përmbaremore është i përshtatshëm për përmbaremore në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*. Nga shikimi i shkresave të lëndës kjo Gjykatë vëren se propozimi për përmbaremore është i pa qartë për faktin se fillimisht nuk i përmbush elementet e përcaktuara me nenin 38 të LPP-së, të cituar më lartë për arsye se në propozimin për përmbaremore nuk është përcaktuar periudha për të cilën kërkohet borxhi si dhe shuma e saj në të cilën kërkohet përmbushja e detyrimit, që e bën të paqartë se për çfarë kërkohet për tërë këtë periudhë borxhi apo vetëm për një periudhë të caktuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë gabimisht është lëshuar në çështjen meritorë, për arsye se fillimisht e njëjta është dashur që të vlerësojë se a përmbushen kushtet për tu proceduar me këtë çështje përmbaremore duke pasur parasysh faktin se ka pasur që në fillim pengesa procedurale, siç është propozimi për përmbaremore i cili nuk është bërë në përputhje me dispozitat ligjore. Gjykata e shkallës së parë është dashur që ta verifikojë propozimin për përmbaremore e më pas të veprojë konform dispozitave ligjore në fuqi, ashtu që të marrë vendim të drejtë e të pranueshëm edhe për këtë Gjykatë.

Gjykata e Apelit, vlerëson se gjykata e shkallës së parë lidhur me këtë çështje ka dështuar që të vërtetojë gjendjen faktike, ashtu që të verifikoj fillimisht a ka bazë juridike për caktimin e përmbaremore, a i përmbushë elementet e nevojshme propozimi për përmbaremore, se a është bërë ky propozim në bazë të dokumentit të besueshëm, të verifikoj se realisht a ekziston detyrimi i debitorit ndaj kreditorit për pagesën e borxhit, e nëse po me saktësi të verifikoj lartësinë e borxhit që e ka debitori ndaj kreditorit dhe për cilën periudhë kërkohet e njëjta.

Në rastet kur debitori e atakon procedurën e përmbaremore si jo të rregullt apo ligjore si dhe kur e atakon dokumentin përmbaremore, nuk ka nevojë të provohet me prova një kundërshtim i tillë, por gjykata në raport me këto pretendime është dashur që të jep sqarime se a përmbushen të gjitha kushtet për tu proceduar më tutje ashtu siç e përcakton edhe Ligji për Procedurën Përmbaremore.

Të gjeturat dhe konstatimet e bëra si më lartë nga gjykata ankimore, aktvendimin e atakuar e bëjnë jo të drejtë dhe pa mbështetje në ligj, me çka si i tillë u dashtë që të anulohet dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë, në rishqyrtim dhe vendosje.

Në ri-procedurë, gjykata e shkallës së parë duhet të veproj në kuptim vërejtjeve të sipërpërmendura, ashtu që fillimisht të veproj në përpikëri në pajtim me dispozitat ligjore të caktuara në procedurën e përmbaremore, me rastin e vlerësimit të propozimit për përmbaremore, të vërtetojë si duhet gjendjen faktike, nëse është e nevojshme të caktojë përsëri seancë dëgjimore-publike, të vlerësojë pretendimet e debitorit në prapësim, e në veçanti ti vlerësojë edhe njëherë shkaqet nga neni 71 të LPP-së, e në përputhje me natyrën e kërkesës dhe dispozitat materiale, të cilat i referohen parashkrimit të kërkesave për bazë të njëjtë, si çështje objekt i përmbaremore, duke pasur parasysh gjithashtu që me rastin e vendosjes meritorë, pa marrë parasysh cili do të jetë përfundimi lidhur me çështjen lëndore, të evitohet shkeljet procedurale të konstatuara si më lartë nga gjykata ankimore, ashtu që vendimin të cilin do ta bie do duhet të përmbajë të gjitha elementet e kërkuara ligjore, siç përcaktohet me nenin 160, e lidhur me nenin 175 të LPK-së, e

pas kësaj të marr vendim meritor, të drejtë dhe të ligjshëm duke i zbatuar dispozitat ligjore në fuqi.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në nenin 3 paragraf 2 të LPP, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika d), të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
CAP.nr.824/2024, të datës 27.06.2024

Gjyqtarja  
Nora Bllaca-Dula. d.v.